



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Departamenti i Kimisë, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune personel ndihmësakademik me karakter mësimor, me kohë të plotë, laborant.

Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor, laborant, varet në punën e tij nga drejtuesi i departamentit; është njësi ndihmëse e procesit mësimor dhe atij kërkimor dhe me veprimtarinë e tij, të udhëhequr nga personeli akademik ndihmon në formimin shkencor e metodik të studentëve.

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta.

Kritere të përgjithshme:

1. Diplomimi: Kandidati duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë në fushën e shkencave natyrore të lidhura me kiminë dhe kiminë e mjedisit. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);
2. Të ketë përvojë të mëparshme pune;
3. Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
5. Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta të kualifikimit,

1. Eksperiencia e punës: Kandidatët duhet të kenë eksperiencë pune në laboratorë të analizave kimike, fiziko-kimike, kimike mjedisore si dhe të analizave industriale.
2. Pjesëmarrja në projekte kërkimore: Përvojë në pjesëmarrje në projekte kërkimore në fushën e shkencave natyrore të lidhur me analizat kimike të ndryshme si dhe të mjedisit.
3. Pjesëmarrje në trajnime dhe/ose kualifikime: Kandidatët duhet të kenë kryer trajnime dhe/ose të kenë kualifikime në fushën e shkencave natyrore të lidhur me kiminë dhe kiminë e mjedisit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

4. Diplomë e gjuhës së huaj: Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të njëres prej 5 gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht (preferohet anglisht).

Çdo kandidat duhet të deklarojë se nuk ka konflikt interesi në përputhje me ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**04.11.2024 - 13.11.2024**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës, laborant, në Departamentin e Kimisë në Fakultetin e Shkencave të Natyës në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave (Ministria e Arsimit dhe Shkencës)
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave (Ministria e Arsimit dhe Shkencës)
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (**04.11.2024 - 13.11.2024**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *laborant*.
Elbasan

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (18.11.2024 – 27.11.2024). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.